



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

ISH PROKURORJA ROVENA GASHI LARGOHET NGA SEANCA PUBLIKE BASHKË ME MOTRËN E SAJ KPA VIJOI GJYKIMIN NË MUNGESË TË SUBJEKTIT TE RIVLERËSIMIT

Komisioni i Posaçëm i Apelimit (KPA) zhvilloi sot më 6 maj, ora 10:00 seancën e radhës me Znj. Rovena Gashi, ish prokurore pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë.

Subjekti i rivlerësimit në seancë i paraqiti trupit gjykues në seancë, një kërkesë (e datës 3 maj 2019 ora 13.43) të Znj. Ema Gashi drejtuar KLGJ nëpërmjet së cilës deklarohet dorëheqja e saj nga detyra si gjyqtare në rrethin gjyqësor Durrës, si dhe dorëheqja dhe mbarimi i statusit të magjistratit në Republikën e Shqipërisë. Kryesuesja e trupit pyeti subjektin, nëse kërkesa për dorëheqje ishte formuluar në bazën të nenit 65 par.3 të ligjit 96/16. Subjekti i rivlerësimit nuk dha shpjegime por kërkoi sërish që të përfaqësohej në këtë proces nga motra e saj. Ndërkohë, trupi gjykues i tërhoqi vëmendjen Znj. Ema Gashit e cila kërkoi të marrë fjalë për të dhënë shpjegime lidhur me kërkesën për dorëheqje drejtuar KLGJ.

Trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm rrëzoi kërkesën e subjektit te rivlerësimit *për t'u përfaqësuar në këtë proces nga Znj. Ema Gashi, e cila është ende gjyqtare në rrethin gjyqësor Durrës, pasi kjo kërkesë është në kundërshtim të hapur me nenin 96, paragrafi i dytë, germa "ç" të Kodit të Procedurës Civile*. Kryesuesja e trupit argumentoi se në baze të nenit 65 të ligjit 96/2016 par. 2 *"dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinimin me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit. Par 3. Në raste të justifikuara, me kërkesë të motivuar dhe me miratim të Këshillit, dorëheqja mund të japë efekte përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të këtij neni"*. Nga deklarimi dhe kërkesa e paraqitur përpara gjykatës nuk rezultoi të ketë një kërkesë të posaçme sipas nenit 65 par 3 te ligjit 96/2019. Pra, nëse do t'i referohemi me afate konkrete sikur ky deklarim do të prodhonte efekte të mbarimit të statusit të magjistratit trupi gjykues vlerëson se ky afat sipas nenit 65 par 2 do të ishte 30 qershor 2019, ndërsa KLGJ do të duhej të shprehej deri në 14 korrik 2019. Nëse kërkesa do të ishte e motivuar sipas parashikimit të nenit 65 par 3 te ligjit 96/2019, atëherë si dorëheqja, por dhe vendimmarrja e KLGJ, do të kishin efekte para afateve kohor të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.

Kryesuesja pohoi se sipas nenit 93 të KPC subjekti i rivlerësimit është në kategorinë e personave të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar. Trupi gjykues vlerësoi gjithashtu se Rovena Gashi nuk është në kategorinë e personave që kanë nevojë për t'u mbrojtur me përfaqësues ligjor të caktuar nga shteti. Znj. Gashi pasi u njoh me vendimin e ndërmjetëm afirmoi se vendimi i trupit gjykues është në kundërshtim me vendime të tjera te KPA (vendimin n.1 date 11.06.2018) dhe duke qenë se trupi gjykues nuk i mundësoi mbrojtjen në këtë proces nga motra e saj, vendosi të largohej nga seanca publike.

Trupi gjykues pas një ndërprerje prej 40 minuta doli me vendim të ndërmjetëm për vijim e gjykimin në mungesë të subjektit të rivlerësimit. Në vazhdim kryesuesja e seancës lexoi të plotë gjetjen dhe provat bashkëlidhur saj të paraqitura nga vëzhguesja ndërkombëtare znj. Mia Roessingh.

Kjo gjetje është paraqitur nga vëzhguesja e ONM-së për arsye se subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur kundër vendimit nr.48 të KPK, ka pretenduar pamundësinë për të qenë e pranishme në seancën publike të zhvilluar nga KPK më datë 20 korrik 2018. Bashkëlidhur këtij ankimi, subjekti i rivlerësimit kishte vendosur një raport mjekësor të lëshuar më datë 18 korrik për të provuar pretendimet e paraqitura.

Gjetja e vëzhgueses konsistonte në lidhje me mungesën e një dokumenti apo certifikate që certifikon shkaqet mjekësore për mungesën e subjektit në seancën e KPK, çka do të kishte çuar në shtyrjen e seancës dëgjimore pranë KPK. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur me ankimin pranë KPA një certifikatë mjekësor të lëshuar më datë 18 korrik e cila nuk është paraqitur asnjëherë përpara KPK. Më datë 20 korrik 2018 bashkëshorti i



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

subjektit ka paraqitur personalisht mbrojtjen me shkrim të subjektit pranë protokollit të KPK në orën 09.11, ai nuk ka paraqitur asnjë certifikatë mjekësore; e-maili i subjektit i datës 20 korrik ora 9.29 minuta dërguar në adresën info@kpk.al përmbante vetëm deklaratën e mbrojtjes dhe nuk i referohej kushteve të saj të pretenduara mjekësore apo një raporti mjekësor (kjo konfirmohet nga teksti i mesazhit përkatës që KPK ka venë në dispozicion). Duke marrë parasysh sa më sipër vëzhguesja e OMN-së kërkoi që deklarata apo parashtrimi i subjektit në lidhje me kushtet e saj të pretenduara mjekësore të vlerësohej me kujdes. Bashkëlidhur gjetjes u paraqitën kopje të fletës përkatëse të regjistrit të protokollit të KPK; kopje të faqes së parë të deklaratës të datës 20.07.18, e-mail i datës 20 korrik 2018 ora 9.29.

Trupi gjykues, pasi administroi gjetjen dhe provat bashkëlidhur saj në fashikullin e çështjes, mbylli shqyrtimin gjyqësor dhe vendosi të tërhiqet për vendim, i cili për arsye objektive të formimit të trupit gjykues do të shpallet më datë 29 maj ora 14.00.